



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË  
BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Nr. 5298 Prot.

Tiranë, më 14/4 /2017

URDHËR

Nr. 34, Datë 14.4 2017

PËR

“FILLIMIN E PROCESIT TË ÇERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM  
NË SEKTORIN PUBLIK PËR SEZONIN 2017-2018”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 1 të nenit 19 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe “Rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.37, datë 16.03.2016, të ndryshuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.26, datë 21.03.2017,

URDHËROJ:

- 1) Fillimin e procesit të certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, në sezonin 2017-2018, dhe hapjen e procedurës së pranimit të aplikimeve të kandidatëve për auditues të brendshëm dhe trajner në këtë proces.
- 2) Të drejtën për të aplikuar, si kandidat për auditues të brendshëm, e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si më poshtë:
  - a) Të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
  - b) Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion;
  - c) Të jenë të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- 3) Kandidatët që aplikojnë për auditues të brendshëm, duhet të paraqesin zyrtarisht në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Kërkesë me shkrim;
  - b) Curriculum Vitae;
  - c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë të noterizuar;
  - d) Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
  - e) Vërtetim punësimi ku specifikohet dhe pozicioni i punës në njësinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
  - f) Certifikatën e gjëndjes gjyqësore.
- 4) Të drejtën për të aplikuar për trajner e kanë personat që plotësojnë kriteret si mëposhtë:
  - a) Trajnerët e kategorisë së parë duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
    - i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6-10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

- ii. Diplomë postmaster apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
  - b) Trajnerët e kategorisë së dytë, duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
    - i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
    - ii. Gradë apo titull shkencor dhe minimalisht 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
  - c) Njohuri të mira të standardeve profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kenë përvojë praktike në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
  - d) Aftësi për të hartuar një program mësimor në lidhje me temat e moduleve dhe ta prezantojë atë në një mënyrë sa më të qartë përpara auditorit;
  - e) Aftësi për të shpjeguar në një mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e programit të certifikimit;
  - f) Aftësi për t’ju përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit, duke përdorur shembuj praktikë;
  - g) Aftësi për të zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore;
  - h) Të kenë përkushtimin e duhur për të këshilluar kandidatët për auditues të brendshëm gjatë gjithë procesit të certifikimit;
  - i) Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi.
- 5) Kandidatët për trajner, duhet të paraqesin zyrtarisht në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Kërkesë me shkrim;
  - b) Curriculum Vitae;
  - c) Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në auditimin e brendshëm;
  - d) Fotokopje të noterizuar të diplomave;
  - e) Rekomandime ose certifikata që vërtetojnë eksperiencën profesionale, aftësitë pedagogjike, si dhe integritet moral dhe reputacion të mirë;
  - f) Certifikatën e gjëndjes gjyqësore.
- 6) Pranimi i dokumentacionit për kandidatët që aplikojnë për auditues dhe për trajner do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhëri.
- 7) Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

